



Në pajtim me nenet 37, 38, 39, 40, dhe nenet 59 dhe 62, të Ligjit nr. 03/L-163, për Minierat dhe Minerale, Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me qëllim të rregullimit, të procedurave, kushteve dhe kriterëve për dhënien e Lejeve për Aktivitete të Veçanta, në mbledhjen e mbajtur me dt. 23.03.2018 nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 002/2018

PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E DHËNIES SË LEJEVE PËR AKTIVITETE TË VEÇANTA

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është që të përcaktojë procedurat, kushtet dhe kriteret për dhënien e Lejeve për Aktivitete të Veçanta, për arsye se Ligji nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale nuk i rregullon të gjitha kriteret për dhënien e Lejeve për Aktivitete të Veçanta.
2. Ky udhëzim administrativ ka për qëllim që KPMM të harmonizoj kriteret e Licencimit me institucionet tjera përgjegjëse që janë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) Ministria e Infrastrukturës, Agjencionin Pyjor të Kosovës, Komunitat dhe Institucione tjera relevante.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky udhëzim administrativ do të zbatohet nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe aplikohen në të gjitha aplikacionet e Lejeve për Aktivitete të Veçanta.
2. Ky udhëzim specifikon qartë kriteret që duhen të zbatohen nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale për aplikacionet e Lejeve për Aktivitete të Veçanta, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Minierat dhe Minerale Nr. 03/L-163 dhe 04/L-158.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këtë kuptim:

- 1.1. **KPMM** - Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.
- 1.2. **LMM** - Ligji për Minierat dhe Minerale.
- 1.3. **MMPH** - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- 1.4. **Leje për Aktivitete të Veçanta** – Lejet për Makineritë për thyerjen , bluarjen dhe seperimin e gurit (**Gurethyes**, Seperacion), Makineri për prodhimin e betoneve (Baza

Betoni), Makineri për prodhimin e asfalteve (Baza të Asfaltit) dhe Makineri për thyerjen, bluarjen, klasifikimin, flotimin duke përdorur reagensë kimik apo klasifikim me metoda tjera të mineraleve (Flotacione).

- 1.5. **Ndërmarrje** – Subjekti i regjistruar sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare i cili aplikon për licencë për hulumtim, licencë për shfrytëzim dhe leje për aktivitete të veçanta apo është e licencuar për hulumtim, shfrytëzim dhe aktivitete tjera minerare nga KPMM-ja, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale.

Neni 4

Dhënia e Lejeve për Aktivitete të Veçanta

1. Leja për aktivitete të veçanta jepet vetëm atëherë kur ndërmarrja ka sjell në KPMM:
 - 1.1. Pëlqimin e vlefshëm nga Komuna përkatëse për zhvillimin e këtij aktiviteti për zonën e përcaktuar në kërkesën e saj. Pëlqimi nga komuna është i vlefshëm vetëm atëherë kur shprehimisht jepet aprovimi për kërkesën e ndërmarrjes për ushtrimin e llojit të aktivitetit të veçantë.
 - 1.2. Dëshminë mbi posedimin e pronës, ose marrëveshje për shfrytëzim të pronës me pronarët e tokës ku ceket edhe destinimi i shfrytëzimit dhe kjo marrëveshje duhet të jetë e vlefshme dhe duhet të ketë kohëzgjatje minimale sa kohëzgjatja e Lejes.
 - 1.3. Kopjet e planit për zonën ku do të ngritën makineritë të destinuara për Lejen për aktivitet të veçanta.
 - 1.4. Të gjitha pëlqimet e nevojshme nga Institucionet kompetente tjera të cilat lidhen me dhënien e kësaj Leje.
 - 1.4.1. Distancën nga rruga mbulon pëlqimi i Ministrisë së Infrastrukturës,
 - 1.4.2. Kushtet mjedisore për Leje afër parqeve nacionale ose monumentet e mbrojtura të natyrës i mbulon pëlqimi Mjedisor i MMPH-së.
 - 1.4.3. Kushtet mjedisore të përcaktuara me Pëlqimin mjedisor nga MMPH-ja mbulojnë distancat nga shtëpitë e banuara ose përkohësisht të banuara, apo objekte të tjera, ku përcaktohen të gjitha masat për mbrojtjen e mjedisit si të tokës, ujit, ajrit nga emisionet ndotëse.
 - 1.4.4. Distancën nga Monumentet arkeologjike e mbulon Pëlqimi nga Instituti për mbrojtjen e Monumenteve arkeologjike i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
 - 1.4.5. Distancat nga objekte tjera të rëndësishme (objektet energjetike, largpërçuesit e tensionit të lartë mbi 35 kv digat, varrezat, objektet e kultit etj) do të mbulohen nga ndërmarrjet me Pëlqimet nga Institucionet përgjegjëse për menagjimin e atyre objekteve.
 - 1.5. Si dhe të gjitha dokumentet e përcaktuara në nenin 38 paragrafi 1 (1.1 deri 1.12) të LMM-së.

2. Me Leje për aktivitete të veçanta munde të pajisen edhe ndërmarrjet të cilat kanë marrëveshje të vlefshme me ndërmarrjet e Licencuara për shfrytëzimin e mineraleve.

2.1. Këto ndërmarrje gjithashtu duhet të plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 5 Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e Lejeve për Aktivitete të Veçanta, është pesë (5) vjeçare, me mundësi vazhdimi.

1.1. Ky afat është përcaktuar duke e vlerësuar si afat të arsyeshëm dhe racional për këto lloje të veprimtarisë në pajtim me nenin 37 par. 1 të LMM-së.

1.2. Pasi që kohëzgjatja e Lejeve për Aktivitetet e Veçanta është 5 vjeçare, protokollet shqyrtuese (matja e tokëzimeve dhe rrufepritisit) të bëhet brenda afatit (2-3) vite.

Neni 6 Aktivitetet e Veçanta në Kuadër të Licencës së Shfrytëzimit

1. Në pajtim me nenin 34 par 1.2. ndërmarrjet kanë të drejtë që të aplikojnë që të ngritin makineri Leje për Aktivitete të Veçanta me këto kriteret:

1.1) Ndërmarrjet me rastin e dorëzimit të aplikacionit për shfrytëzim duhet të dorëzojnë edhe projektet për makineri, duke përfshirë të gjitha projektet si në rast të aplikimit të rregullt;

1.2) Përveç Licencës së Shfrytëzimit ndërmarrjes do të jepet edhe Leja për Aktivitet të Veçantë në kohëzgjatje 5 vjeçare;

2. Në KPMM Aplikacioni do të shqyrtohet si një aplikacion i vetëm dhe në data bazë vendoset si tillë, me sqarime lidhur me aktivitetin e veçantë.

3. Në Licencën e lëshuar shënohet: Licencë Shfrytëzimi me Seperacion.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi 8 dite pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



Musa Shabani
Kryesuesi i Bordit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale